



Republika e Kosovës
Republican Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 46/16

Prishtinë, më 19.02.2016, ora 16:00

Ndertesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontić, Labinote Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Adem Grabovci, Ilir Deda, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj.

Gjithashtu të pranishëm të ftuar ishin: Avdullah Hoti, Ministër i Financave.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i Raportit me amendamente për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe nr.05/L-068

Kryetari- theksoi se ka pasur një takim me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së në Kosovë, lidhur me Projektligjin dhe si rezultat ata kanë dërguar disa sugjerime për ndryshimin dhe plotësimin e tij. Në draft propozimet që keni përpara, janë tri amendamente. Amendamenti i parë ka të bëjë me ndryshimin e nenit 21/A të ligji bazik, ku është propozuar që procedurat e prokurimit për agjencitë e pavarura që kanë më pak se 50 punonjës dhe që i përgjigjen Kuvendit, ti kryej Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe jo Kuvendi, për shkak të mungesës së kapaciteteve. Ndërkaq ajo që duhet diskutuar është paragrafi 3, ku është paraparë që KRPP shqyrton kërkesat e autoriteteve kontraktuese që kanë më pak se 50 punonjës dhe vendos se a mund ti zhvillojnë vet procedurat e prokurimit apo këtë duhet ta bëjë Qeveria apo ministritë për agjencitë që iu përgjigjen atyre, apo Agjencia Qendrore e Prokurimit për agjencitë e pavarura. Sa i përket amendamentit 2 është rregulluar procedura e propozimit dhe emërimit të kryetarit dhe anëtrëve të OSHP-së. Kurse me amendamentin e tretë të propozuar është rregulluar mënyra e suspendimit, largimit apo shkarkimit të kryetarit, respektivisht ndonjë anëtar të OSHP-së, nëse akuzohet apo kryen ndonjë vepër penale.

Avdullah Hoti – KRPP nuk ka kompenca për vendosjen e kryerjes apo mos kryerjes së procedurave të prokurimit. Këtë gjë e bënë Agjencia Qendrore e Prokurimit. Prandaj, propozojë që të fshihet paragrafi 3. Për agjencitë që i përgjigjen Qeverisë apo ministrive dhe që kanë më pak se 50 punojnës, procedurat e prokurimit ti kryen Qeveria, respektivisht ministritë. Ndërkaq për agjencitë e pavarura që kanë më pak se 50 punonjës dhe që i përgjigjen Kuvendit, procedurat e prokurimit ti kryej Agjencia Qendrore e Prokurimit. Agjencia Qendrore e Prokurimit, aktualisht nuk ka kapacitete për kryerjen e këtyre procedurave të prokurimit, por që zyrtaret e prokurimit të agjencive të pavarura duhet të transferohen në AQP. Ndërkaq, në amendamentin 2 që i referohet ndryshimeve në nenin 100 të ligjit bazik, në paragrafin 4.3. do të ishte mirë që të parashihet mundësia që ndër kushtet të jenë edhe profesionet tjera, që do të mund të kryenin edhe provimin e jurisprudencës.

Kryetari - në bazë të Ligjit për Provime Jurisprudencës, vetëm kandidatët me përgaditje në fushën e drejtësisë kanë të drejtë për paraqitjen e provimit.

Avdullah Hoti – nëse është ashtu siq thotë kryetari, atëherë nënparagrafi 4.3. mund të fshihet, pasi që nënparagrafi 4.4. parasheh kryerjen e provimit të jurisprudencës.

Safete Hadergjona – propozojë që në amendamentin 2, që i referohet ndryshimeve të nenit 100, në paragrafin e 2, në fjalën e tretë, para fjalës vlerëson, të shtohet edhe fjala “interviston”.

Labinotë Demi-Murtezi – propozojë që nënparagrafi 4.5. të riformulohet si vijon: 4.5. të ketë së paku 3 (tre) vjet përvojë profesionale në njërin nga këto fusha: drejtësi, administratë publike, financa publike ose prokurim;

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Raport me rekomandime

- I. Komisioni shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe nr.05/L-068, dhe propozojë amendamentet si vijon:

Amendamenti 1

Neni 1, pas nenit 1, shtohet neni i ri 2, si vijon:

Neni 2

Neni 21/A i ligjit bazik, zëvendësohet me tekstin si vijon:

Neni 21/A Ekonomizimi i aktivitetit të prokurimit

1. Për qëllim të ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministritë përkatëse kryejnë procedurat e prokurimit të Agjencive që i përgjigjen atyre, të cilat kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës.
2. Për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës, procedurat e prokurimit i kryen Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Amendamenti 2

Neni 2, riformulohet si vijon:

Neni 2

Neni 100 i ligjit bazik, zëvendësohet me tekstin si vijon:

Neni 100

Emërimi i kryetarit dhe anëtarëve të OSHP-së

1. Bordi i OSHP-së përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve të emëruar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, pa të drejtë riemërimi.
2. Qeveria i propozon Kuvendit së paku dy kandidatë për pozitën e lirë të kryetarit të OSHP-së dhe së paku dy kandidatë për secilën pozitë të lirë të anëtarëve të OSHP-së, të paktën 90 (nëntëdhjetë) ditë para skadimit të mandatit të kryetarit dhe anëtarëve aktualë. Kuvendi emëron kryetarin dhe secilin anëtarë të OSHP-së, bazuar në rekomandimin e dhënë nga një organ përzgjedhës i pavarur. Organi përzgjedhës i pavarur interviston, vlerëson dhe klasifikon me pikë kandidatët bazuar në meritë. Kuvendi emëron kandidatët me pikët më të larta për pozitën e kryetarit dhe për secilën pozitë të lirë të anëtarëve të OSHP-së. Në çdo rast, organi përzgjedhës i pavarur ia dorëzon Kuvendit listën e plotë të kandidatëve të vlerësuar.
3. Organi përzgjedhës i pavarur, sipas paragrafit 2 të këtij neni, themelohet nga Kuvendi dhe përbëhet prej tre gjyqtarëve të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
4. Çdo kandidatë që propozohet për kryetar ose anëtar të OSHP-së, duhet të ketë kualifikimet dhe plotësojë kriteret vijuese:
 - 4.1. të jetë shtetas i Kosovës;
 - 4.2. të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale ose të mos jetë i akuzuar për ndonjë vepër penale;
 - 4.4. të ketë të përfunduar provimin e jurisprudencës;

- 4.5. të ketë së paku 3 (tre) vjet përvojë profesionale në njërin nga këto fusha: drejtësi, administratë publike, financa publike ose prokurim;
- 4.6. të ketë aftësi për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndërgjegjshme, me vendosmëri dhe përgjegjshmëri.

Amendamenti 3

Neni 3, riformulohet si vijon:

Neni 3

Neni 101 i ligjit bazik zëvendësohet me tekstin si vijon:

Neni 101

Suspendimi, largimi dhe shkarkimi i kryetarit dhe anëtarëve të OSHP-së

1. Nëse ndaj kryetarit apo një anëtari të OSHP-së ngritët aktakuzë për vepër penale, ai/ajo suspendohet me pagesë prej 50% (pesëdhjetë për qind) të pagës së tij/ saj, deri në largimin e tij/saj ose derisa të shpallet i pafajshëm me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës. Suspendimi hyn në fuqi që nga momentin i ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorit.
2. Gjykata kompetente në ditën e ngritjes së aktakuzës ndaj kryetarit apo ndonjë anëtari të OSHP-së e dërgon njoftimin tek Kryetari i Kuvendit, i cili në emër të Kuvendit si institucion që e ka emëruar, e njofton OSHP-në për suspendimin e kryetarit apo anëtarit të tij.
3. Kryetari ose anëtari i OSHP-së largohet nga detyra nëse ai/ajo shpallet fajtor për ndonjë vepër penale me anë të aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës. Ky largim hyn në fuqi që nga momenti i shqiptimit të aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës, me të cilin aktgjykim njoftohet kryetari i Kuvendit, i cili në emër të Kuvendit, si institucion që e ka emëruar, e njofton OSHP-në për largimin e kryetarit apo anëtarit të tij.
4. Përveç siç është paraparë në paragrafin 2 të këtij neni, Qeveria i propozon Kuvendit, shkarkimin e kryetarit apo një anëtari të OSHP-së, nëse ai/ajo vepron në kundërshtim me etikën profesionale që ndërlidhet me detyrat e tij/saj.

- II. Raporti me amendamente procedohet shqyrtim të dytë në Seancë Plenare dhe për vlerësim në Komisionet tjera të përhershme.

Mbledhja përfundoi në ora 16:15

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani